

**VENDIM**  
**Nr. 326, datë 31.5.2023**

**PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË  
TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË  
ADMINISTRATËS PUBLIKE**

*(Ndryshuar me Vkm nr. 796, datë 28.12.2023; nr. 422, datë 26.6.2024)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen punonjësit mbështetës dhe punonjës të tjerë të specialiteteve të ndryshme (në vijim punonjësit) në:

a) institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, në nivel qendror e në administratën e prefektit;

b) institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, në nivel rajonal/vendor.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve, të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, janë si më poshtë vijon:

a) Paga bazë për klasë;

b) Shtesa për vjetërsi në punë;

c) Shtesa për funksion drejtues;

ç) Shtesa për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin;

d) Shtesa për natyrë të veçantë pune, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Punonjësit e institucioneve, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, trajtohen me sistemin e pagës bazë për klasë me 9 klasa, sipas lidhjes I, “Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi”.

4. Punonjësit e institucioneve, të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, trajtohen me sistemin e pagës bazë për klasë me 13 klasa, sipas lidhjes II, “Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi”.

5. Renditja e pozicioneve të punës për punonjësit e institucioneve, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas krerëve I/1 deri në I/11, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

6. Renditja e pozicioneve të punës për punonjësit e institucioneve, të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas krerëve II/1 deri në II/3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

7. Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet për çdo vit pune, në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Përfshihen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

8. Punonjësit kur punojnë në funksione drejtuese përfitojnë shtesë mbi pagën bazë për klasë në përqindje, sipas shkallëzimit në 5 (pesë) grupe, si më poshtë vijon:

a) Grupi i parë: 5%;

- b) Grupi i dytë: 10%;
- c) Grupi i tretë: 15%
- ç) Grupi i katërt: 20%;
- d) Grupi i pestë: 30%.

9. Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, si më poshtë vijon:

- a) Në shkallën e parë, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj;
- b) Në shkallën e dytë, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj;
- c) Në shkallën e tretë, në masën 5 500 (pesë mijë e pesëqind) lekë në muaj;
- ç) Në shkallën e katërt, në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë në muaj.

Ndarja e punëve, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, bëhet sipas lidhjes III, “Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Zbatimi i shtesës së përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi, sipas shkallëve përkatëse të vështirësisë e të dëmshmërisë bëhet, si më poshtë vijon:

a) Drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, u paraqesin kërkesën e tyre drejtorive të shëndetit publik, të cilat përcaktojnë vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve, si dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë, për çdo vend pune;

b) Pas përcaktimit të shkallës së vështirësisë e dëmshmërisë, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, titullarët e institucioneve paraqesin kërkesën për miratim në ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit;

c) Pas marrjes së miratimit nga dy ministrinë e përmendura në shkronjën “b”, të kësaj pike, titullarët miratojnë dhënien e këtyre shtesave për punonjësit e institucioneve të sistemit të tyre. Për institucionet qendrore, në varësi të ministrave të linjës, si dhe ato rajonale e vendore, ky miratim bëhet nga ministri përkatës, në varësi të të cilit janë këto institucione;

ç) Kur punonjësit i takon të marrë dy a më shumë shtesa, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, ai do të marrë nga një shtesë vështirësie për çdo shkallë, por jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

d) Këto shtesa, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë së pozicioneve të punës, u rekomandohen edhe punëdhënësve të tjerë të administratës publike, pagat e të cilëve nuk përcaktohen sipas këtij vendimi apo edhe subjekteve private.

11. Paga dhe shtesa mbi pagë për punonjës in që punon në pozicionin “shofer i titullarit” është, si më poshtë vijon:

a) Në rastet kur titullarët e institucioneve, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, janë të klasifikuar në grupin “A” për efekt të ligjit përkatës për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, dhe të cilët, në bazë të ligjit përkatës për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë, kanë në dispozicion shoferë që nuk janë punonjës të Gardës së Republikës, shoferi i titullarit përfiton pagën bazë mujore sipas klasës VI, të lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mujore për natyrë të veçantë pune, në masën 13 500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind) lekë në muaj;

b) Në rastet kur titullarët e institucioneve, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, janë të klasifikuar në grupet “B” dhe “C”, për efekt të ligjit përkatës për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, dhe të cilët, në bazë të ligjit përkatës për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë, kanë në dispozicion shoferë, shoferi i titullarit përfiton pagën sipas klasës V, të lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mujore për natyrë të veçantë, në masën 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj;

c) Shoferët e titullarëve të tjerë, të cilët, në bazë të ligjit përkatës për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë, kanë në dispozicion shoferë, përfitojnë

pagën sipas klasës IV, të lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mujore për natyrë të veçantë pune, në masën 6 500 (gjashtë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

12. Për natyrë të veçantë pune u jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse, konkretisht:

a) punonjësve të sektorit të teknikës së shtypshkrimit në Qendrën e Botimeve Zyrtare, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) punonjësve shpëtues të sektorit të emergjencave dhe shpëtimit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

c) punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

ç) punonjësve në pozicionin “shofer-mekanik” në Qendrën e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

d) punonjësve, të cilët punojnë në shërbimet e shëndetit mendor e që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me pacientët me probleme të shëndetit mendor, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj. Ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë përcakton vendet e punës, që përfitojnë këtë shtesë me miratimin e strukturave të institucioneve shëndetësore përkatëse;

dh) punonjësve, të cilët punojnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të dënuarit, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj. Kjo shtesë aplikohet pas miratimit të strukturave të institucioneve të ekzekutimit të veprave penale përkatëse, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë;

e) punonjësve në pozicionin “shofer” në urgjencën e spitaleve, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

ë) punonjësve në pozicionin “rojë mjedisore” në administratat e zonave të mbrojtura, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj;

f) punonjësve në pozicionet “përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)”, “kuzhinier”, “administrues hoteli” dhe “ndihmëskuzhinier” në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

g) punonjësve në pozicionet “laborant” dhe “teknik i mesëm aparaturash” në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në masën 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

gj) punonjësve në pozicionin “punëtor mirëmbajtjeje (krematoriumi)” në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

h) punonjësve në pozicionet “mjeshtër ndriçimi/fonie” dhe “mjeshtër rrobaqepës” në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj;

i) punonjësve në pozicionet “mjeshtër skene”, “mjeshtër parukier-grimier”, “mjeshtër garderobier”, “mjeshtër marangoz”, “mjeshtër këpucar”, “ndihmësmjeshtër grimier”, “mjeshtër dekorori”, “mjeshtër rekuizite” “ndihmësmjeshtër rrobaqepës”, “ndihmësmjeshtër rekuizitier”, “ndihmësmjeshtër dekorator”, “ndihmësmjeshtër këpucar”, “ndihmësmjeshtër marangoz”, “ndihmësmjeshtër i mekanikës skenike”, “ndihmësmjeshtër parukier-grimier” dhe “ndihmësmjeshtër gardërobier”, në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

j) punonjësve në pozicionet “mjeshtër ndriçimi/fonie” në Teatrin Kombëtar, në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj;

k) punonjësve në pozicionet “mjeshtër skene”, “mjeshtër parukier-grimier”, “mjeshtër garderobier”, “mjeshtër marangoz”, “mjeshtër këpucar”, “mjeshtër dekorori”, “mjeshtër rekuizite” “ndihmësmjeshtër grimier”, “ndihmësmjeshtër ndriçim/fonie”, “ndihmësmjeshtër rekuizitier”, “ndihmësmjeshtër dekorator”, “ndihmësmjeshtër këpucar”, “ndihmësmjeshtër marangozërie”, “ndihmësmjeshtër i mekanikës skenike”, në Teatrin Kombëtar, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

l) punonjësit në pozicionin “magazhinier”, në Kryeministri në masën 23 000 (njëzet e tre mijë) lekë në muaj;

ll) punonjësit e tjerë mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe në institucionet e pavarura në nivel qendror, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj;

m) punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, që nuk përfshihen në shkronjat “a” deri në “ll”, të kësaj pike, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.

13. Paga mujore për punonjësit, që punojnë në pozicionin “prozektor” në Institutin e Mjekësisë Ligjore, është e njëjtë me pagën mujore për të njëjtin pozicion pune në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

14. Vendimi nr. 234, datë 20.4.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

15. Efektet financiare<sup>1</sup>, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku

Lidhja I

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë
1	I	40 000
2	II	41 000
3	III	41 800
4	IV	42 500
5	V	43 000
6	VI	44 000
7	VII	45 500
8	VIII	46 300
9	IX	47 000

Lidhja II

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë
1	I	40 000
2	II	41 000
3	III	41 800
4	IV	42 500
5	V	42 800
6	VI	43 200
7	VII	43 600
8	VIII	44 100
9	IX	44 800
10	X	45 300
11	XI	45 700
12	XII	46 000
13	XIII	46 700

Lidhja III

Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës të vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin

<sup>1</sup> Vendimi nr. 422, date 26.6.2024 botuar në F.Z nr. 108, date 1.7.2024 në pikën 2 të tij shprehet: “2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga buxheti i miratuar dhe fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.”

Në zbatim të pikës nr. 9 të këtij vendimi, punë që kryhen në kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, konsiderohen ato punë që kryhen në ambiente që kapërcejnë kufijtë e lejueshëm të faktorëve të dëmshëm për shëndetin, që përcaktohen në dispozita të veçanta ose në norma të detyrueshme higjieno-sanitare.

Ndarja e punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin është si vijon:

#### 1. Në shkallën e parë përfshihen punët që kryhen:

a	Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave, që nuk shkaktojnë dëmtime të mushkërisë;
b	Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike, që nuk depozitohen në organizëm;
c	Në ambientet e mbyllura, në të cilat për arsye teknologjike mbahet konstante temperatura mbi 25 gradë, ose nën 10 gradë celsius;
ç	Në një ambient të lagësht me lagështi relative të ajrit mbi 80 për qind, në baltë ose në kontakt të drejtpërdrejtë me ujë;
d	Në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit ultraviolet ose infra të kuqe, për shembull saldimi, farkëtimi etj.;
dh	Në kushtet e vibrimit të përgjithshëm;
e	Në ambientet në të cilat është i domosdoshëm përdorimi i ndriçimit artificial.

#### 2. Në shkallën e dytë përfshihen punët që kryhen:

a	Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave që shkaktojnë dëmtime të mushkërisë;
b	Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike që depërtojnë në organizëm;
c	Në kushtet e ekspozimit ndaj zhurmave;
ç	Në kushtet e presionit të ulur ose të ngritur për arsye të procesit teknologjik;
d	Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të vibrimit lokal, për shembull përdorimi i pajisjeve pneumatike me dorë;
dh	Në kushtet e një mbingarkese fizike të llogaritur të paktën 1.100 kilokalori për burrat dhe 600 kilokalori për gratë ose që kërkojnë një pozicion të detyruar për trupin;
e	Në praninë efciente potencialisht me burime infeksioni të rrezikshme, në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të hormoneve dhe antibiotikëve që shkaktojnë çrregullime të veprimtarisë fiziologjike të organizmit, si dhe të faktorëve të tjerë me veprim të njëjtë si hormonet dhe antibiotikët, në qoftë se kjo do të njihet nga institucioni përgjegjës për higjienën dhe epidemiologjinë.

#### 3. Në shkallën e tretë përfshihen punët që kryhen:

a	Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të fushave elektromagnetike me frekuencë të lartë në intervalin nga 0,1 deri 300.000 mHz në zonën e rrezikut;
b	Në kushte veçanërisht të rrezikshme: i. në lartësinë mbi 2 m ose në thellësinë nën 2 m kur punohet në prani të rrezikut; ii. që lidhen me prodhimin, përdorimin, magazinimin dhe transportimin e gazeve dhe materialeve shpërthyes; iii. brenda rezervuarëve, aparateve, kanaleve, puseve etj. kryerja e të cilave kërkon leje speciale nga drejtuesi i ndërmarrjes ose institucionit; iv. në pajisjet elektroenergjetike që ndodhen nën tension mbi 220 V, që kryhen në përputhje me udhëzimet për mbrojtjen në punë; v. që lidhen me ngarkimin dhe shkarkimin e lëndëve djegëse të lëngëta, si dhe transportimin e tyre; vi. nën tokë ose nën ujë; vii. në punët me të sëmurët e shëndetit mendor, në shërbimin e anatomisë patologjike e të mjekësisë ligjore, në repartet me rrezikshmëri të lartë infektive; viii. në repartet e sëmundjeve onkologjike.

#### 4. Në shkallën e katërt përfshihen punët që kryhen:

a	Me benzidinë, alfa dhe beta naftiloaminë, klorvinil;
b	Në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit jonizues, si dhe faktorë të tjerë me veprime analogjike, në qoftë se kjo do të njihet nga Instituti i Shëndetit Publik.

Kreu I/1

Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës	Shtesë për funksion (grupi)
1	Përgjegjës i sektorit të teknikës në Qendrën e Botimeve Zyrtare.	IX	5
2	Ofsetist në Qendrën e Botimeve Zyrtare.	IX	
3	Përgjegjës zyre.	VIII	5

4	Sekretar rektori. Teknik shtypshkronje, façosës në Qendrën e Botimeve Zyrtare.	VIII	
5	Përgjegjës ofiçine e transporti.	VII	1
6	Sekretar i titullarëve të tjerë. Bibliotekar në bibliotekën shkencore të universitetit dhe të Akademisë së Shkencave. Drejtues Skafi në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare. Fotoreporter në ATSH. Fotograf në ATSH. Vëzhgues terreni në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve.	VII	
7	Bibliotekar në bibliotekat e fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes. Restaurator. Arkivist. Protokollist. Laborant. Llogaritar. Kontrollor anketimi në INSTAT. Topograf.	VI	
8	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme. Operator në INSTAT. Administrator dokumentesh në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe në drejtorinë e arkivave në qarqe. Magaziniçer.	V	
9	Operator. Preparator. Kolektor. Punonjës blegtorie. Drejtues mjetesh motorike/motobarke. Punëtor i rasateve të peshkut. Anketues. Shofer për automjete mbi 2.5 tonë dhe automjete speciale.	IV	
10	Shofer. Shaptilografist. Fotokopjues. Kaldaist. Punëtor mirëmbajtës. Punëtor porti. Punonjës shërbimi.	III	
11	Nëpunës informacioni. Centralist.	II	
12	Rojë. Korrier. Postier. Lulishtar. Punonjës pastrimi/sanitar.	I	

Kreu I/2

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës të punonjësve të administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Kryeministrit**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës	Shtesë për funksion drejtues (grupi)
1	Përgjegjës arkivi. Përgjegjës administrate.	VIII	4
2	Përgjegjës i teknikës së shumëfishimit.	VII	3
3	Arkivist. Llogaritar. Operator. Kameraman. Fotograf.	VII	
4	Punonjës shtypshkronje, shumëfishimi. Teknik të specialiteteve të ndryshme.	VI	

	Magaznier. Receptionist. Shofer-korrier.		
5	Punëtorë të tjerë. Shofer.	V	
6	Punonjës pastrimi.	II	

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

### Kreu I/3

#### Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Shkollës së Magjistraturës

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Punonjës i ruajtjes së rendit.	VII
2	Teknik mirëmbajtjeje. Operator. Magaznier. Shofer i kryetarit.	VI
3	Shofer i Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe i Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Shofer-korrier.	V
4	Shoferë të tjerë.	IV
5	Punonjës pastrimi.	II

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

### Kreu I/ 4

#### Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të punonjësve të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Zëvendësuar me Vkm nr. 796, datë 28.12.2023)

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit; Oficer informacioni në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Sekretar; Ndihmës (sekretari – protokoll); Punonjës i postës sekrete.	VII
2	Shofer drejtuesi në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Teknik mirëmbajtjeje; Operator; Magaznier.	VI
3	Shofer i postës sekrete; Kuzhinier në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shofer prokurori në Prokurorinë e Posaçme.	V
4	Shoferë të tjerë të institucionit.	IV
5	Punonjës pastrimi.	II

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

### Kreu I/5

#### Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të disa institucioneve të sistemit të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë

Nr.	Emërtimi i pozicionit	Klasa e
-----	-----------------------	---------

rendor		pagës
<b>I</b>	<b>Në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar</b>	
1	Teknik gjeolog dhe të specialiteteve të ndryshme. Punëtor (mjeshtër shpimi, sondist, special, armator, mekanik, specialist, elektrikist, tornitor, saldator, axhustator, llamarinist).	VI
2	Operator. Kompjuterist. Heliografist. Disenjator. Kopist. Shofer i ekspeditave.	V
3	Ndihmësondist. Ndhmësminator. Ndhmësarmator. Ndhmësteknik.	III
<b>II</b>	<b>Në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera</b>	
1	Teknik i mesëm në: - Laboratorin e provave të litarëve të çelikut; - Emergjencën dhe shpëtimin; - Mirëmbajtjen (kolaudimin) e pajisjeve shpëtuese; - Mirëmbajtjen dhe kolaudimin e automjeteve.	VIII
2	Teknik i mesëm për komunikimin, informacionin dhe ruajtjen e institucionit. Shofer i automjeteve të gatishmërisë.	VI

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

#### Kreu I/6

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit, Institutit të Policisë Shkencore dhe Qendrës së Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Ndhmësmjek. Bibliotekar. Sekretar. Kryekuzhinier. Ndhmësfarmacist.	VI
2	Teknik armatimi. Teknik ndërtimi. Kujdestar/magaziniër (për armatime dhe të tjera). Infermier. Kuzhinier.	V
3	Shofer autoambulance.	IV
4	Kartelist. Evidencier. Inventarizues. Rrobaqepës. Kamerier. Kolaudator. Furnitor.	III
5	Mirëmbajtës ushqimi. Ndhmëskuzhinier. Punonjës ngarkim-shkarkimi. Zhblokues.	II
6	Lulishtar. Mirëmbajtës.	I

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

#### Kreu I/7

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të disa institucioneve të sistemit të ministrisë përgjegjëse për kulturën**

Nr.	Emërtimi i pozicionit	Klasa
-----	-----------------------	-------



rendor		e pagës
<b>I</b>	<b>Në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor dhe në Teatrin Kombëtar</b>	
1	Përgjegjës për bibliotekën muzikore në TOB; Mjeshtër Skene; Mjeshtër Ndrëçimi/Fonie; Mjeshtër Parukier-grimier; Mjeshtër Rrobaqepës; Mjeshtër Gardërobier; Mjeshtër i Dekorit; Mjeshtër Marangoz; Mjeshtër Rekuizite; Mjeshtër Këpucar.	IX
2	Ndihmësmjeshtër grimier/rrobaqepës/rekuizitier/këpucar/marangozerie/i mekanikës skenike; Punonjës marketingu.	VIII
3	Ndihmësmjeshtër ndrëçim/fonie/rekuizitier/dekorator	VII
4	Punëtor skene	IV
5	Punëtor shërbimi	III
6	Biletashitës	II
<b>II</b>	<b>Në Galerinë Kombëtare të Arteve, Muzeun Historik Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare, Qendrën Kombëtare Kulturore për Fëmijë, Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, Qendrën Muzeore Berat - Muzeun Ikonografik "Onufri" - Muzeun Etnografik Berat, Qendrën Muzeore Krujë - Muzeun "Skënderbeu" - Muzeun Etnografik Krujë, Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi", Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Cirkun Kombëtar</b>	
1	Restaurator në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore	VII
2	Ndihmësbibliotekar; Piktor/skulptor/piktor ekzekutues në QKKF.	VI
3	Elektracist; Fonist; Butaforist.	V
4	Vëzhgues salle; Ruajtës fondesh; Fototekist; Katalogues; Punëtor restaurimesh.	III
5	Punëtor skene; Gardërobier.	II
6	Biletashitës.	I

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/8**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve qendrore**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Kontrollor cilësie në Qendrën e Riparimit të Nivelit të Katërt të Pajisjeve Tokësore e në Bazën e Riparimit të Aviacionit. Mbikëqyrës riparimi në Qendrën e Riparimit të Nivelit të Katërt të Pajisjeve Tokësore e në Bazën e Riparimit të Aviacionit. Manovrator në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.	VIII
2	Montazhier grafist. Ndihmësspecialist në prodhim e riparim të nivelit të IV në pajisjet tokësore dhe të nivelit të III në pajisjet ajrore. Ofsetist në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.	VII
3	Bibliotekar. Sekretar. Kryekuzhinier. Farmacist. Topograf. Kryeinfermier.	VI

	Operator audioviziv. Ndhmësspecialist në prodhim e riparim të nivelit të III në pajisjet tokësore dhe të nivelit të II në pajisjet ajrore.	
4	Teknik armatimi. Teknik ndërtimi. Kujdestar/magazinier (për armatime dhe të tjera). Infermier. Kuzhinier. Faqosës. Provokopist. Fotograf e kopist. Arkivist i fondeve filmike e fotografike. Fotoreporter. Furnitor/kolaudator në Qendrën e Riparimit të Nivelit të Katërt të Pajisjeve Tokësore e në Bazën e Riparimit të Aviacionit.	V
5	Shofer autoambulance. Shofer automjeti transporti mbi 2.5 tonë.	IV
6	Kartelist. Evidencier. Inventarizues. Rrobaqepës. Ndhmësinstrukturor. Libralidhës. Furnitor.	III
7	Mirëmbajtës ushqimi. Ndhmëskuzhinier. Punonjës ngarkim shkarkimi. Zhbllokues. Rrobalarës.	II
8	Lulishtar. Mirëmbajtës.	I

Shënim:

a) Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

b) Institucionet e sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes që paguhen sipas kësaj lidhjeje janë: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtoria e Shifrës, Akademia e Forcave të Armatosura, Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, Komanda dhe Shtabi i Forcës Tokësore, Komanda dhe Shtabi i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, Komanda dhe Shtabi i Forcës Ajrore, Komanda dhe Shtabi i Komandës Mbështetëse, Qendra e Kulturës Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i Forcave të Armatosura, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Qendra e Personel Rekrutimit, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, Qendra e Arsimimit Profesional të nënoficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarit në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse.

**Kreu I/9**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve civilë të Qendrës së Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve Patrulluese për Rojën Bregdetare të Shqipërisë, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Teknik i kualifikuar në repartet e prodhimit të anijeve. Teknik i kualifikuar në repartet e riparimit të anijeve.	VIII

2	Përpunues të projekteve e skicave. Sekretar. Përkthyes. Kostoist/normist.	VII
3	Protokollist-arkivist. Sekretar. Operator. Magaznier për karburantet.	VI

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/10**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës	Shtesë për funksion drejtues (grupi)
1	Përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)	IX	3
2	Përgjegjës (gjelbërimi, aktivitete të tjera ndihmëse).	VIII	
3	Kuzhinier. Administrues hoteli. Banakier.	VII	
4	Ndihmëskuzhinier.	VI	
5	Kamerier. Recepsionist.	V	
6	Punonjës hotelerie. Punonjës gjelbërimi.	II	
7	Punëtorë kuzhine; Punëtorë restoranti; Punëtorë lavanterie.	I	

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu I/11**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Shofer i kryetarit të KLGJ-së. Shofer i kryetarit të KLP-së. Teknik mirëmbajtjeje. Magaznier.	VI
2	Shofer i anëtarit të KLGJ-së. Shofer i anëtarit të KLP-së. Shofer-korrier.	V
3	Nëpunës informacioni. Shoferë të tjerë.	IV
4	Punonjës pastrimi.	II

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu I/1.

**Kreu II/1**

**Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi dhe të disa institucioneve të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes**

Nr.	Emërtimi i pozicionit	Klasa	Shtesë për
-----	-----------------------	-------	------------

rendor		e pagës	funksion drejtues (grupi)
1	Manovrator i makinerive të rënda. Manovrator në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.	XIII	
2	Ndihmësmanovrator i makinerive të rënda.	XII	
3	Punonjës i gjendjes civile në bashki.	XI	
4	Kryetar dege në arsimin parauniversitar. Kryekujdestar në qendrat e përkujdesjes sociale. Përgjegjës ofiçine e transporti. Përgjegjës grupi në drejtoritë rajonale të mirëmbajtjes së rrugëve dhe Drejtorinë e Riparimit të Makinerive të Furnizimit në Tiranë.	X	3
5	Punonjës i gjendjes civile në njësi administrative.	X	
6	Shofer me automjete speciale. Kryesondist. Shofer në sektorin e helikopterëve të Repartit Special "RENEA" në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes.	IX	
7	Meteorolog. Ndhimësmjek. Laborant. Sekretar. Sekretar shkollë në shkollat e arsimit të mesëm të lartë. Kryekuzhinier. Kryeinfiermier. Farmacist. Arkivist. Llogaritar/ekonomist i mesëm. Shofer automjeti transporti mbi 2.5 tonë dhe mjeteve speciale. Anketues. Motopompist. Topograf. Teknik i mesëm në strukturat e teknologjisë së informacionit, në sistemin e Policisë së Shtetit. Roje mjedisore me arsim të lartë.	VIII	
8	Sekretar shkollë në shkollat e arsimit bazë. Arkiviste gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit. Bibliotekar. Programist. Instruktor. Metodist. Kujdestar në qendrat e përkujdesjes sociale. Shofer transporti me automjet mbi 2.5 tonë. Administrator i sistemeve të ndërlidhjes. Polombar. Roje mjedisore me arsim të mesëm.	VII	
9	Teknik i mirëmbajtjes së pajisjeve tokësore, ajrore, detare, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes. Minator. Ndërlidhës. Piktor. Disenjator. Punonjës sekretarie.	VI	
10	Teknik të mesëm të specialiteteve të ndryshme. Teknik armatimi. Kujdestar/magaziner (për armatime dhe të tjera). Përgjegjës i godinave të shtëpive të pushimit. Teknik ndërtimi. Fenerist detar. Ekspeditor. Dispeçer. Infermier. Kuzhinier.	V	

	Fotograf. Fotoreporter. Telekronist. Zetorist. Operator audioviziv. Montazhier grafist.		
11	Operator. Magazinier. Shofer autoambulance.	IV	
12	Kartelist. Evidencier. Inventarizues. Rrobaqepës. Kamerier. Kolaudator. Kopjues notash. Daktilografist. Fotokopjues. Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme. Punëtorë të bazave prodhuese. Shofer autoveture. Shofer automjeti transporti deri 2.5 tonë. Roje me armë. Ftues. Furnitor. Fillrojtës.	III	
13	Ndihmëskuzhinier. Kaldaist. Drejtues të motoçikletave dhe motokarrove. Punonjës ngarkim shkarkimi. Zhbllokues; Gardërobier. Këpucar. Berber.	II	
14	Lulishtar. Pjatararës. Rrobalarës. Biletashitës. Roje pa armë. Punonjës shërbimi. Sanitar/pastrues. Korrier. Centralist.	I	

Shënim. Institucionet e sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes që paguhen sipas kësaj lidhjeje janë: Shtëpitë e Pushimit të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura, Qendra e Menaxhimit të Materialeve, Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake, Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, batalionet/kompanitë/qendrat stërvitore në Forcën Tokësore, distriktet detare/flotiljet detare/Shërbimi Hidrografik/Qendra e Vëzhgimit Detar/Qendra e Zhytjeve/Qendra Stërvitore/Kompanitë mbështetëse në Forcën Detare, Baza Ajrore/Shërbimi Meteorologjik Ushtarak/Qendra e Kontroll Raportimit/Qendra Stërvitore/Kompani në Forcën Ajrore, Batalion/Kompani/Qendra Stërvitore në Komandën Mbështetëse, Kompani/Qendra në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Kreu II/2

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të drejtorive rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit**

Nr. rendor	Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës
1	Magazinier.	VII
2	Punëtorë ngarkim-shkarkimi.	IV
3	Inventarizues.	II

	Punëtorë.	
--	-----------	--

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu II/1.

**Kreu II/3**

**Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë  
të punonjësve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emërtimi i pozicionit</b>	<b>Klasa e pagës</b>
1	Shofer autoambulance, autoburgu; Ndihmësmjek.	VIII
2	Kujdestar.	VII
3	Ndihmësfarmacist dhe magazinier.	V

Shënim. Për emërtesat e pozicioneve të punës, klasat e të cilave nuk janë përcaktuar në këtë lidhje, përdoret kreu II/1.